




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. Prot. 01-248/15
 Nr. I faq. 02
 Data 30-01-2015
 Broj stranica
 Datum
 Nr. pages
 Date
 PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.01.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4697-14 për z.*Ibish Mazreku – Ushtrues detyre (U.D.) Pro Dekan në Universitetin “Haxhi Zeka” Pejë, për shkak se ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4697-14, për Zyrtarin e lartë, z. *Ibish Mazreku – Pro Dekan në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë*, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. *Ibish Mazreku* fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK-01-4746/14), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç ‘rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.*Ibish Mazreku*, është deklaruar se në funksionin e Prodekanit, (që e radhitë në mesin e Zyrtarëve të lartë), është i emëruar vetëm si ushtrues detyre, prandaj do ta shqyrtoj mundësinë që të dorë hiqet me dëshirë nga ushtrimi i këtij funksioni publik.

Agjencia kundër Korrupsionit i ka sqaruar se dorëheqja nga funksioni publik tash për tash nuk është kërkesë e Agjencisë, sepse ka mundësi që situata e konfliktit të interesit të shmanget edhe me ndryshimet në biznes, por megjithatë mbetet në dëshirën e zyrtarit *Mazreku* që të zgjedhë cilën formë ta aplikoj për të shmangë situatën e konflikti të interesit.

Ndërkohë, z.*Mazreku*, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Universiteti publik “*Haxhi Zeka*” në Pejë (03-344/15), në të cilën shihet se z.*Mazreku* ka dhënë

Dorëheqje të përvokueshme nga funksioni Ushtrues Detyre i Prodekanit për çështje financiare dhe Infrastrukturë në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

Po ashtu bashkë me këtë shkresë z.Mazreku ka sjellë edhe Vendimin për miratimin e dorëheqës së tij (DPK/DPKI-03-02/202/15).

Në bazë të kësaj, tani z.Mazreku nuk ushtron funksion të zyrtarit të lartë publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Hasan Prifti /